



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1164 Prot.  
13

Tiranë, më 14 / 11 2016

REKOMANDIM

Nr. 29 datë 14 / 11 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", Zyra e Komisionerit ka kryer hetim administrativ në ngarkim të kontrolluesit Hotel "AS"- *Harmonia HG sh.p.k. Durrës*, në përfundim të të cilit,

KONSTATOVA:

Në zbatim të Urdhërit Nr.233, datë 26.10.2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të dalë për realizimin e këtij hetimi administrativ, nga grupi i inspektimit u realizua kontrolli pranë kontrolluesit Hotel "AS"- *Harmonia HG sh.p.k. Durrës*, konform procedurave administrative, me objekti kontrolli si më poshtë:

- Zbatimi i Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit, "AS"- *Harmonia HG sh.p.k. Durrës*.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhërin Nr. 233, datë 26.10.2016 të Komisionerit.

**Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:**

1. Kontrolluesi nuk e ka kryer Njoftimin në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, por e ka kryer atë gjatë procesit administrativ.
2. Kontrolluesi nuk aplikon Deklarata Konfidencialiteti me punëmarrësit.
3. Kontrolluesi nuk ka rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale.

Faktet e mësipërme përbëjnë shkelje administrative të neneve 21, 27 dhe 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar.

Në cilësinë e provës materiale, këtij procesverbali i bashkëngjiten këto dokumente:

- Kartelë klienti.
  - Fotografi të ambienteve.
  - Ekstrakt i QKR-QKB.
  - Urdhër i brendshëm, datë 10.09.2015.
  - Tabela elektronike e listës me të dhënat e klientëve.
  - Kontratë individuale pune.
1. Në kontrollin e ushtruar pranë këtij kontrolluesi dhe në bazë të dokumentacionit të mbledhur nga ky kontroll, konstatohet se me Urdhër të administratorit të grupit “*Harmonia*” Hotels Group sh.p.k., datë 10.09.2015, është urdhëruar në parim: “...zbatimi i Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Për çdo informacion, çdo subjekt i të dhënave personale mund ti drejtohet faqes zyrtare të Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” Ky urdhër ishte ekspozuar në hyrjen e hotelit.
  2. Kartela e klientit kishte të përfshirë përmbajtjen e urdhërit si më lart cituar dhe informacionin për klientin, mbi ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Në përmbyllje të procesit administrativ, në prani të përfaqësuesve të kontrolluesit u hartua dhe lexua procesverbali i mbajtur për këtë rast. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk paraqitën pretendime, por u shprehën se do të përmbushin detyrimet që dalin nga ky kontroll.

Përfaqësuesit e kontrolluesit ishin bashkëpunues me grupin e kontrollit dhe në asnjë moment nuk e shmangën atë.

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përpara marrjes së aktit final, kontrolluesi Hotel “AS”- *Harmonia HG sh.p.k. Durrës*, në ushtrim të së drejtës për tu dëgjuar është njoftuar zyrtarisht për pjesëmarrje në seancë dëgjimore që do zhvillohej në datë 10.11.2016.

Kontrolluesi, Hotel “AS”- *Harmonia HG sh.p.k. Durrës*, ka dokumentuar gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, riparimin e të gjitha gjetjeve nga grupi i kontrollit.

Zyra e Komisionerit, vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e hetimit, i cili ka qenë i ndërsjellë në funksion të zbatimit të ligjit.



Sa më sipër:

Në zbatim të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, neni 31 pika 1, gërma "a/1",

### REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Hotel "AS"- *Harmonia HG sh.p.k. Durrës*, në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha proceset e reja të mundshme në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
2. Kontrolluesi Hotel "AS"- *Harmonia HG sh.p.k. Durrës*, në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të marrë masat për të përfshirë në faqen e tij të internetit rubrikën "Politikat e Privatësisë".
3. Kontrolluesi Hotel "AS"- *Harmonia HG sh.p.k. Durrës*, duhet të realizojë detyrimet rekomanduese të këtij akti në vazhdimësi për pikën e parë dhe brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për pikën e dytë nga dalja e këtij rekomandimi.
4. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008. "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht, në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 14 . 11 .2016

